



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANË

NR. AKTI 5635

NR. VENDIMI 9519



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR

TIRANE

Nr: 5635 Regj. Themeltar

Nr:9519 Vendimi

VENDIM

“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane e përbërë nga :

Gjyqtar : ERVIN POLLOZHANI

asistuar nga sekretare gjyqesore **Gencjana Dada**, sot më datë **24. 11. 2016** mori në shqyrtim në seancë gjyqesore publike, çështjen civile me **Nr. 5635 Regj. Themeltar** që i përket :

PADITËS: **SHOQËRIA “****” sh.p.k. me seli në ***, e përfaqësuar në gjykim me autorizim datë *** nga av. *** dhe av. ***.**

I PADITUR: **“****” person fizik i regjistruar ne QKB me NIPT *** me adrese *** (ne mungese me shpallje).**

PERSON I TRETË: **DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MARKAVE DHE E PATENTAVE, me adresë Bulevardi “Zhan D’Ark” Ish shtepia e Ushtarakëve, Kati i IV Tiranë, e perfaqesuar ne gjykim me autorizim perfaqesimi Nr. *** Prot. dt. *** nga *** (në mungesë).**

OBJEKTI:

1. Konstatimin e konkurrencës së pandershme nëpërmjet përdorimit të paautorizuar të markes tregtare “Zgara Korçare” nga pala e paditur.
2. Ndalimin e përdorimit të paautorizuar të markes “Zgara Korçare” në qarkullimin tregtar nga pala e paditur.
3. Shpërblimin e dëmit jopasuror në shumën *** (***) lekë.
4. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

BAZA LIGJORE: Neni 348 i K. Pr. Civile. Nenet 638, 639 e vijues të K. Civil. Ligji Nr. 9947 datë 07. 08. 2008 “Për

Pronësinë Industriale” Neni 156 e vijues.

Gjykata pasi dëgjoi pretendimet perfundimtare te perfaqesuesit te pales paditese, i cili kërkoj: *Pranimin e kërkesë-padise sipas objektit te saj*, perfaqesuesen e personit te trete e cila ne seancen gjyqesore qe mori pjese shprehu se *e linte ne çmim te gjykates zgjidhjen e kesaj çeshtjeje*, pasi administroi provat shkresore dhe shqyrtoi çeshtjen në tërësi ne mungese me shpallje te te paditurit, në përfundim të saj,

VEREN :

Se, paditesi shoqeria « *** » sh.p.k. nepermjet perfaqesueseve te saj i eshtë drejtuar kësaj Gjykate me kerkese-padine me objektin e siperpermendur.

Ne seance gjyqesore pala paditese kerkoi saktesimin e pikes se trete te objektit te kerkese padise (ne lidhje me vleren e demit) ne referim te Nenit 185 te K. Pr. Civile, kerkese kjo qe u pranua si e tille nga gjykata nisur nga fakti se eshte ne diskrecionin e pales paditese disponibiliteti mbi objektin e kerkese-padise.

Pas kalimit te ketij moment procedural, fillimisht, gjykata bazuar ne Nenet 36, 41, 43, 59, 348 te K. Pr. Civile, konstatoi se çeshtja bën pjesë në juridiksionin gjyqësor civil dhe kjo gjykate eshte kompetente nga pikepamja e kompetences lendore e tokesore.

Pala paditese, bazuar ne Nenin 32 te K. Pr. Civile dhe Nenin 348 te K. Pr. Civile legjitimohet t'i drejtohet gjykates me kete kerkese-padi per te konstatuar ekzistencen e nje konkurence te pandershme nepermjet perdorimit te nje marke tregtare.

Gjithashtu gjykata, në vështrim të Neneve 71, 72 dhe 73 të K. Pr. Civile, çmoi se nuk ekzistojnë për të, shkaqe papajtueshmërie, ose përjashtimi nga ky gjykim, fakt ky i pa kundërshtuar dhe nga pala prezent në gjykim.

Në bazë të nenit 35 të K. Pr. Civile gjykimi u zhvillua nga një gjyqtar.

Nga shqyrtimi gjyqesor rezultoi e provuar se :

Pala paditëse shoqëria “***” sh.p.k, është një shoqëri e së drejtës tregtare shqiptare e cila ka fituar personalitetin juridik me regjistrimin e saj me dt. 21. 04. 2005. Si objekt te veprimtarisë se saj, nder te tjera kjo shoqeri ka dhe *** dhe eksport-import te artikujve te ndryshëm ushqimore, industriale, pijeve alkolike.

Në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe për nevoja të aktivitetit tregtar, shoqëria “***” sh.p.k. ka regjistruar Markën Tregtare “Zgara Korçare” në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave me datë depozitimi 17 Dhjetor 2012, me numër regjistrimi kombëtar ***, datë regjistrimi 28 Qershor 2013.

Nëpërmjet kërkesë-padisë së paraqitur pala paditëse ka parashtruar se pas regjistrimit të markës tregtare në pronësi të saj është vënë në dijeni prej disa muajsh për përdorimin e markës tregtare “Zgara Korçare” në territorin shqiptar nga subjekte të paautorizuar prej saj.

Një ndër këto subjekte sipas palës paditëse është aktiviteti që ushtron pala e paditur “****”-person fizik i cila sipas ekstraktit të QKR-se datë 18. 02. 2016 rezulton te jete e regjistruar si person fizik me Nipt ***, me objekt veprimtarie produkte zgate. Pikerisht per kete objekt aktiviteti pala e paditur ka hapur nje aktivitet per tregtimin e ketyre produkteve me adrese ne ***, ku emrin e aktivitetit e ka shenuar me tabele “Zgara Korçare”, që është njëkohësisht marka tregtare në pronësi të palës paditëse.

Në datën 24 Nëntor 2015 shoqëria “****” sh.p.k, i është drejtuar palës së paditur duke kërkuar ndalimin e përdorimit të paautorizuar të markës “Zgara Korçare” në qarkullimin tregtar, si mbajtës i së drejtës për markën tregtare duke i lënë një afat 30 ditor për njoftimin e pushimit të cënimit, por pala paditëse nuk ka kryer asnjë veprim në këtë drejtim.

Në kushtet e mos reagimit dhe marrjes së masave nga ana e palës së paditur e cila megjithëse është vënë në dijeni për markën në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k, pala paditëse ka pretenduar se pala e paditur ka vazhduar me përdorimin e markës në qarkullimin tregtar dhe për rrjedhojë pala paditëse i është drejtuar Gjykatës me padinë për shqyrtim për konstatimin e për shkeljen e të drejtave mbi markën në pronësi të shoqërisë “****” sh.p.k në përputhje me Ligjin Nr. 9947 datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale”, kapitullit XXVII nenit 167 “Ushtrimi i të drejtave” me këtë përmbajtje: *“1. Aplikanti, pronari i markës së regjistruar, personi i licencuar, përdoruesi i autorizuar i një marke kolektive ose çdo person tjetër, të drejtat e të cilit, të parashikuara në dispozitat e këtij ligji, shkelen, mund të ngrenë padi në gjykatë kundër shkeljes së të drejtave. Për qëllim të këtij kapitulli, pronarët e markave, që janë të mirënjohura në Republikën e Shqipërisë, në kuptim të nenit 6 bis të Konventës së Parisit, në përputhje me shkronjën “ç” të pikës 5 të nenit 143 të këtij ligji, gëzojnë të njëjtat të drejta, që gëzojnë pronarët e markave të regjistruara.*

2. Çdo përdorim, kufizim, imitim ose bashkëshoqërim i paautorizuar, që bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, përbëjnë shkelje të së drejtës së markës së regjistruar ose të një marke, për të cilën është paraqitur një aplikim për regjistrim, sipas ligjit.

3. Personi, sipas kuptimit të pikës 1 të këtij neni, ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës kundër çdo personi, që shkel të drejtat e tij, për të kërkuar:

a) ndalimin e veprimeve të tjera në shkelje të të drejtave;

b) heqjen ose bllokimin e objekteve, që përbëjnë shkelje të të drejtave, nga qarkullimi civil ose, nëse nuk ka rrugë tjetër, shkatërrimin e këtyre objekteve;

c) heqjen ose bllokimin e mjeteve të përdorura ekskluzivisht apo pothuajse ekskluzivisht për krijimin ose prodhimin e produkteve që përbëjnë shkelje apo, nëse nuk ka rrugë tjetër, shkatërrimin e tyre;

ç) publikimin e vendimit përfundimtar të gjykatës në median publike me shpenzimet e personit që ka kryer shkeljen, në mënyrën e parashikuar nga gjykata.

4. Shkelësi është përgjegjës për të gjitha dëmet që i janë shkaktuar paditësit. Gjykata, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, vendos masën e dëmshpërblimit, përveç kur është parashikuar ndryshe dhe mund, sipas rastit:

a) të marrë parasysh të gjitha aspektet përkatëse, siç janë pasojat

negative ekonomike, përfshirë fitimet e munguara, që ka pësuar pala e dëmtuar, çdo fitim të padrejtë, të realizuar nga shkelësi dhe, sipas rastit, elemente të tjera përveç faktorëve ekonomikë, si dëmi moral, që i është shkaktuar mbajtësit të të drejtave nga shkelja;

b) të vendosë kompensimin e dëmeve me shuma të menjëhershme, në bazë të elementeve, si shuma e të ardhurave ose tarifave, që do të siguroheshin apo merreshin, në rast se shkelësi do të kishte kërkuar autorizim për përdorimin e së drejtës së pronësisë intelektuale në fjalë.

5. Padia kundër shkeljes së të drejtave duhet të depozitohet në gjykatë brenda 3 vjetëve nga data, kur paditësi merr dijeni për shkeljen dhe shkelësin”.

Gjykimi për palen e paditur u zhvilluar në mungesë me shpallje pasi nga njoftimi i dërguar kësaj pale rezultonte sipas shenimit: “i panjohur në këtë adresë”, duke vlerësuar në këtë mënyrë gjykata qëndrimin e kësaj pale në harmoni me provat e administruara në gjykim dhe shpjegimet e pales paditese.

Nga ana e saj gjykata referuar objektit dhe bazës ligjore të kerkese-padise si dhe përpos shpjegimeve të palëve ndërgjyqëse çmon se referuar Nenit 6 të K. Pr. Civile përcaktohet se: “Gjykata që gjykon mosmarrëveshjen duhet të shprehet mbi gjithçka që kërkohet dhe vetëm për atë që kërkohet”. Nga ana tjetër Neni 16/1 përcakton se “Gjykata zgjidh mosmarrëveshjen në përputhje me dispozitat ligjore..... Gjykata nuk mund të ndryshojë bazën juridike të padisë pa kërkesën e palës. Në Nenin 28 të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se: “Gjykata duhet të shprehet për të gjitha kërkesat që parashtrihen në padi, pa i kaluar kufijtë e saj, duke realizuar një gjykim të drejtë, të pavarur dhe të paanshëm brenda një afati të arsyeshëm”. Në kuptim të këtyre dispozitave gjykata në ushtrimin e veprimtarisë së saj, udhëhiqet gjithnjë nga ligji, nuk e paragjykon çështjen objekt gjykimi dhe u krijon palëve të gjitha hapësirat ligjore për të realizuar një proces të drejtë gjyqësor. Cilësimi juridik i fakteve bëhet në përputhje me cilësimin ligjorë të tyre.

Në analizë të pretendimeve të palëve dhe provave të paraqitura, gjykata çmon se padia e ngritur është pjesërisht e bazuar në prova dhe ligj dhe si e tillë duhet të pranohet, kjo për sa me poshte arsyetohet.

Sa i përket *legjitimitetit aktiv*. Pala paditëse është pronare e ligjshme, e çertifikuar e markës tregtare “Zgara Korçare”, regjistruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Patentave dhe Markave me datë depozitimi 17 Dhjetor 2012, me numër regjistrimi kombëtar ***, datë rregjistrimi 28 Qershor 2013. Marka tregtare përfaqëson një nga format e pronësisë industriale dhe në interpretim të normave ligjore në fuqi dhe të detyrueshme për zbatim gjykata sqaron se me termin pronë do të kuptohen një sërë interesash ekonomikë në funksion të qëllimit të të drejtës së pronës, duke përfshirë për këtë pronën e luajtshme dhe të paluajtshme, interesat pasurore dhe jo pasurore. Pala paditëse në cilësinë e pronarit të kësaj marke tregtare legjitimohet t'i drejtohet gjykatës me padi të paraqitur proceduralisht në gjykatën kompetente, formalisht të rregullt, për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë mbi markën tregtare.

Për sa i përket *legjitimit pasiv* padia i kundersdrejtohet mbajtësit të së drejtës së pretenduar. I padituri "****" person fizik rezultoi të jetë përdorues i markës tregtare "Zgara Korçare". Ai në aktivitetin e tij ka të vendosur tabelën me të njëjtin emër në vendin ku ushtron veprimtarinë e tij. Megjithatë pala paditëse i është drejtuar me shkresë të paditurit për ndalimin e përdorimit të saj që në muajin nëntor 2015, pala e paditur nuk i ka kthyer asnjë përgjigje dhe nuk ka marrë asnjë masë për ndalimin e cënimit të markës. Nga pamjet, foto të paraqitura nga pala paditëse shihet vendosja e tabelës "Zgara Korçare", në adresën që sipas ekstratit të QKR-se, është adresa e vendit të ushtrimit të veprimtarisë tregtare nga i padituri.

Duke ju referuar ligjit Nr. 9947 "Për Pronësinë Industriale" datë 07. 07. 2008 neni 156 të tij, veprimi i kryer nga ana e palës së paditur bie në kundërshtim me ligjin pasi vetëm pronari i markës së regjistruar ka të drejtën ekskluzive të përdorimit të saj.

Gjatë e hetimit gjyqësor rezultoi e provuar se pala paditëse është pronar i regjistrimit për markën "Zgara Korçare" (fjalë të stilizuara—e zezë, e bardhë, kafe dhe nuancat e saj) e regjistruar në regjistrin e Markave dhe Patentave pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Markave dhe Patentave prej 28 Qershor 2013 ndërmjet një regjistrimi kombëtar dhe mban Nr. *** e regjistruar në Klasën 43 (Restorante), të Klasifikimit të Nicës.

Marka e regjistruar nga pala paditëse dhe marka tregtare e vendosur nga pala e paditur në ambientet ku ushtron veprimtari tregtare janë fontetikusht identike, shenjat janë ekstremisht të ngjashme. Fjalët janë të stilizuara në të njëjtën mënyrë; kanë të njëjtën strukturë dhe kanë të njëjtin kuptim leksikologjik. Gjithashtu vendosja e fjalëve, kuptimi dhe informacioni që ato përcjellin janë identike. Kjo lloj ngjashmërie përbën burim konfuzioni tek konsumatori në lidhje me markën tregtare dhe me produktet dhe cilësitë që përfaqëson.

Në Ligjin Nr. 9947 07. 07. 2008 "Për Pronësinë Industriale" neni 140 "Çdo shenjë ose kombinim shenjash, që paraqitet grafikisht dhe që shërben për të dalluar mallrat apo shërbimet e një personi fizik ose juridik, nga ato të një personi tjetër fizik ose juridik, është markë që përfaqëson ato mallra ose shërbime, me kusht që të përmbushen kërkesat e neneve 141 deri në 143 të këtij ligji (në vijim do të quhet "markë").

2. Përbëjnë marka shenjat e mëposhtme:

a) fjalët, përfshirë emrat personalë, shkronjat, numrat, shkurtimet;

b) shenjat figurative, përfshirë vizatimet;

c) format dy ose tredimensionale, format e mallrave dhe/ose ambalazhimi i tyre;

ç) kombinimet e ngjyrave e të dritë-hijeve, si dhe ngjyrat në vetvete;

d) çdo kombinim i shenjave, të përmendura nga shkronjat "a" deri në "ç" të kësaj pike.

3. Markat regjistrohen vetëm nëse ato mund të paraqiten grafikisht. Kjo lidhet veçanërisht me lloje të veçanta markash, si zëri dhe sinjalet e dritës, por jo vetëm me këto.

Duke ju referuar kësaj dispozite, marka tregtare e regjistruar është e paraqitur grafikisht, përmban elementët thelbësorë me karakter dallues për të diferencuar dhe arritur tek konsumatori me synimin që ky i fundit të

mund të dallojë këtë markë nga një tjetër. Marka Zgara Korçare (fjalë dhe element stilizuar) me numër Rregjistrimi nacional *** me datë rregjistrimi 17 Dhjetor 2012, është regjistruar në përputhje me pikën 1, 2 (a, d) të nenit 140 si dhe pikës 3 të tij pasi është paraqitur në formë grafike, si fjale dhe kombinim ngjyrash. Qëllimi i markës tregtare është krijimi i një përqsajeje të konsumatorit ose me saktë lidhja që vjen midis markës dhe produktit që ai tregon e përkthyer me pas në reputacion të saj në qarkullimin tregtar.

Mallrat që ofrohen nga palët ndërgjyqëse kanë qene të njëjta dhe në këto kushte prezumohet se kane sjelle konfuzion tek konsumatori. I padituri **** person fizik rezulton të jetë përdorues i paautorizuar i Markës tregtare “Zgara Korçare”, gjë që rezulton si nga fakti se megjithëse pala paditëse i është drejtuar me shkresë për ndalimin e përdorimit të saj dhe pala e paditur nuk i ka kthyer asnjë përgjigje dhe nuk ka pasur asnjë reagim tjetër, ashtu edhe nga pamjet, fotot të paraqitura nga pala paditëse ku shihet vendosja e tabelës në adresën e vendit të ushtrimit të veprimtarisë tregtare nga i padituri. Pra, pala e paditur e ka përdorur sa kohë që ka tregtuar të njëjtin shërbim sikundër dëshmohet nga fotot e administruara në cilësinë e provës dhe megjithëse ka qënë në dijeni për pronësinë e kësaj marke.

Per nevoja te krahasimit vizual te markes se perdorur nga pala e paditur ne raport me marken “Zgara Korçare” te rregjistruar ne pronesi te pales paditese gjate gjykimit u realizua nje ekspertim grafik, nga i cili konkludua se: *“Duke krahasuar emertimin e dy subjekteve ne gjykim percaktoj se ndryshimi i fontit te emertimit “Zgara Korçare” nga “Mistral“ ne “Century”, ngjyra e germave nga e bardhe ne te verdhe si dhe ngjyra kafe e sfondit e (perbashket) nuk perbejne ndryshim. Emertimi i njejte dhe diferencat e vogla grafike nuk permbushin kushtet per ta cilesuar kete emertim identifikues, te ndryshem nga ai i markes tregtare te rregjistruar”.*

Sa me siper gjykata konkludon se ne aspektin vizual emertimi i perdorur nga pala e paditur per identifikimin e sherbimit te ofruar ka ngjashmeri te theksuara ne raport me marken tregtare “Zgara Korçare” e regjistruar ne pronesi te pales paditese. Ne te dy rastet komponenti identifikues eshte elementi verbal “Zgara Korçare”, i stilizuar, i cili eshte dominues ne sfondin e perdorur. Ky element eshte inkorporuar teresisht ne emertimin e perdorur nga pala e paditur. Ndryshimi ne llojin e shkrimit dhe nuancat e peraferta ne ngjyra te perdorura nga pala e paditur nuk zbehin ngjashmerine e theksuar me marken e regjistruar nga pala paditese “Zgara Korçare”. Ndersa ne aspektin fonetik emertimi “Zgara Korçare” i perdorur nga pala e paditur eshte identik me marken e regjistruar nga pala paditese, duke krijuar konfuzion ne dallimin e sherbimeve te ofruara nga secili subjekt.

Mundesia per konfuzion ne treg e konsumatorit mes markes se regjistruar konform ligjit dhe asaj qe perben imitim perfshin elementet bashkelidhes qe krijojne ngjashmeri jo vetem ne raport me shenjat ne aspektin vizual, por dhe me mallrat dhe sherbimet qe ato identifikojne. Ne kete rast merret ne konsiderate shkalla e vemendjes se nje konsumatori mesatar i cili identifikimin e sherbimit apo produktit, ne varesi dhe te natyres se tij, ia beson memorjes vizuale te markes dhe jo perqendrimit ne elementet e vecante dallues mes saj apo nje marke imituese.

Ne rastin objekt gjykimi sherbimet e identifikuar nga pala e paditur permes emertimit "Zgara Korçare" (sherbime restoranti te produkteve te zgares te identifikuar me elementin gjeografik te zones se origjines) jane identike me sherbimet qe mbulon marka e regjistruar nga pala paditese "Zgara Korçare". Duke i bashkalidhur ketij elementi ngjashmerite vizuale dhe perputhshmerine fonetike mes markes se paditesit dhe asaj te perdorur nga pala e paditur evidentohet qartazi konfuzioni i pashmangshem ne treg mes sherbimeve te ofruar nga secili prej ndergjyqesave.

Sa me siper eshte evidente se pala e paditur gjate ushtrimit te aktivitetit te tij tregtar (prodhime zgare) perdor ne menyre te paautorizuar dhe ne kundershtrim me ligjin marken e regjistruar nga pala paditese "Zgara Korçare". Ky konstatim eshte konkluzion i analizes se sipercituar te elementeve thelbesor krahasues vizual, fonetik dhe konceptual mes markes se paditesit dhe markes imituese te perdorur nga pala e paditur. Perdorimi i markes "Zgara Korçare" nga pala e paditur vjen ne kundershtrim me dispozitat e ligjit "Per pronesine industriale" qe konturon qartesisht sjelljen tregtare te subjekteve ne qarkullimin civil ne respektim te drejtave te pronesise industriale te njohura me pare, regjistruar dhe mbrojtur ne formen e kerkuar nga ligji nga nje tjetër subjekt. Kjo situatë kundralishmerie legjitimon palen paditese ne kerkimin e saj per pushimin e cenimit te perdorimit te markes "Zgara Korçare" nga pala e paditur referuar nenit 156 te ligjit "Per pronesine industriale". Ne keto kushte gjykata çmon se kjo pjese e kerkimit te padise duhet pranuar duke urdheruar ndalimin e perdorimit te paautorizuar te markes "Zgara Korçare" ne qarkullimin tregtar ne vendin ku ushtron aktivitetin i padituri "****"-person fizik, konkretisht ***, i cili detyrohet te heqe emertimin "Zgara Korçare".

Në nenin 638 të Kodit Civil parashikohet se: *"Në varësi të dispozitave që kanë lidhje me mbrojtjen e shënjave dalluese dhe të drejtave të patentës, veprimet e konkurrencës së pandershme kryhen prej cilitdo që: a) Përdorë emrat ose shënjat dalluese të cilat mund të sjellin ngatërresë me emrat dhe shënjat të përdorura ligjërisht nga të tjerë ose imiton produktet e një konkurrenti ose kryen veprime të cilat mund të sjellin ngatërresa me produktet dhe veprimtarinë e një konkurrenti; b) Përdorë vetë drejtpërdrejt ose tërthorazi cdo mjet tjetër që nuk përputhet me parimet e ndershmërisë profesionale dhe mund të dëmtojë veprimtarinë e tjetrit.*

Nenit 10 bis pika 3 Konventa e Parisit 1883 detyron vëndet anëtare të ndalojnë të gjitha veprimet që bien ndesh me praktika tregtare të tilla sa konfuzioni merret i mirëqënë, gjendje kjo që krijon mbrojtje të gjerë përfshirë markën tregtare, shenjat dalluese, etiketat, shfaqjet ambalazhuese, formë ose ngjyrë të mallrave, apo çdo tregues tjetër të mallrave që përdoret nga një biznesmen.

Në kushtet e mësipërme, gjykata konstaton kryerjen e veprimeve që cënojnë të drejtat e pronësisë mbi markën tregtare "Zgara Korçare" nga i padituri.

Pala paditëse ka kërkuar në objektin e padisë edhe një vlerë si dëmshpërblim për dëmin jo pasurorë ***lekë të ardhur si pasojë e përdorimit të pautorizuar dhe shkeljen e së drejtës mbi markën dhe konkurrencën e

pandershme. Ky kërkim gjen mbështetje në ligjin e poosaçëm nenet 184/b dhe nenin 184/c dhe në dispozitat e Kodit Civil, nenet 608, 625 ashtu edhe praktikën Unifikuese të Gjykatës së Lartë, sipas Vendimit Nr. 12, datë 14. 09. 2007 ku cilësohet se: *“Në gjykimet me objekt detyrimet që rrjedhin nga shkaktimit të dëmit nëse paditësi kërkon dëmshpërblimin “për të gjitha dëmet” apo “për të gjitha dëmet pasurore dhe jo pasurore”, kjo mënyrë përbën disponiomin e tij për kërkimin e dëmshpërblimit për cdo figurë të dëmit pasuror ose jo pasuror”.*

Nga provat dhe debati i zhvilluar në procesin gjyqësor rezultoi e provuar lidhja shkakësore materiale ndermjet sjelljes së paligjshme (veprimit a mosveprimit) e me faj dhe dëmit të shkaktuar. Personi përgjegjës në rastin konkret është subjekti i paditur, personi fizik “***”, i cili me veprimet e tij të paligjshme, duke reklamuar dhe përdorur emrat ose shënjat dalluese “Zgara Korçare” tregton mallra të njëjtë me palën paditëse, i cili është mbajtësi i së drejtës për Markën Tregtare “Zgara Korçare”, duke krijuar konfuzion tek konsumatori. Këto veprime konsiderohen të kryera me faj, pasi siç është konstatuar në proces i padituri ka pasur vullnetin për të përfituar ekonomikisht duke e reklamuar markën tregtare të mbrojtur në ambientet e aktivitetit të tij tregtar dhe nuk ka vepruar menjehere pas ardhjes në dijeni të tij për këtë fakt, për ta ndaluar këtë as pasi pronari i kësaj marke, “*** ***” sh.p.k. e ka njoftuar për të drejtat e mbrojtura mbi të. Këto veprime të të paditurit kanë sjellë si pasojë cënimin e emrit të mirë tregtar “Zgara Korçare” duke i sjellë dëme ekonomike pronarit të saj, shoqërisë “*** ***” sh.p.k.

Në nenin 184 pika 4 e ligjit Nr. 9947 dt. 07. 07. 2008 “Për Pronësinë Industriale”, parashikohet se : *“Shkelësi është përgjegjës për të gjitha dëmet që i janë shkaktuar paditësit. Gjykata, në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, vendos masën e dëmshpërblimit, përveç kur është parashikuar ndryshe”....*

Pala paditëse nuk ka paraqitur pretendime për rekuperimin e pasojave eventuale ekonomike nga cënimi i të drejtave mbi markën tregtare, por ka pretenduar vetëm dëmin jopasuror në shumën ***lekë. Duke vlerësuar në tërësi rrethanat e faktit, gjykata vlerëson kryesisht sjelljen e të paditurit pas njoftimit me shkrim të palës paditëse mbi të drejtat mbi markën tregtare dhe kohëvazhdimin e cënimit të këtyre të drejtave. Mosveprimi i menjehershëm i palës së paditur për marrjen e masave për ndalimin e përdorimit të kësaj marke tregtare, passjell cënim të markës tregtare dhe për pasojë cënimin edhe të emrit dhe reputacionit të pronarit ligjor të saj. Në këto kushte gjykata, duke vlerësuar të gjitha rrethanat çmon të caktojë një dëmshpërblim në favor të palës paditëse në shumën *** (***) lekë.

Nga ana tjetër referuar Nenit 106 të K. Pr. Civile gjykata çmon se shpenzimet gjyqësore, taksa e padise 1% e vlerës së detyrimit të pranuar, shpenzimet e ekspertimit në masën *** lekë si dhe shpenzimet e perfaqësuesit të palës paditëse, janë në ngarkim të palës së paditur. Por lidhur me shpenzimet e perfaqësimit në gjykim që sipas fatures tatimore Nr. *** dt. 22. 11. 2016 të paraqitur në konkluzionet perfundimtare janë në masën *** leke, gjykata nga ana e saj çmoi të mos e pranojë këtë vlerë të shpenzimeve gjyqësore për perfaqësimin në gjykatë në këtë masë, pasi e gjen atë jo reale

lidhur me natyren e konfliktit gjyqesor, kohezgjatjen e procesit, si dhe ne shperpjestim me interesat pasurore te paleve ndergjyqese lidhur me te drejtat dhe detyrimet reciproke.

Ne kete menyre gjykata njeh si shpenzime perfaqesimi per palen paditese, vleren e miratuar me aktet ligjore ne fuqi per perfaqesimin ne shkallen e pare, ne masen *** leke, kjo sipas Urdhërit Nr. 1284/3, datë 16. 03. 2005 “Për miratimin e tarifave të shpërblimit të avokatëve për dhënien e ndihmës juridike”.

PËR KËTO ARSYE :

Gjykata bazuar ne Nenet 126, 306-308 e vijues te K. Pr. Civile, si dhe Neni 348 i K. Civil,

VENDOSI :

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesë-padisë.
2. Konstatimin e konkuresces se pandershme nepermjet perdorimit te paautorizuar te markes tregtare “Zgara Korçare” nga pala e paditur “***” person fizik.
3. Ndalimin e perdorimit te paautorizuar te markes tregtare “Zgara Korçare” ne qarkullimin tregtar ne vendin ku ushtron aktivitetin personi fizik “***” duke urdheruar te paditurin te heqe nga ambientet ku ushtron aktivitetin emertimin e markes tregtare “Zgara Korçare”.
4. Detyrimin e të paditurit “***” person fizik, të dëmshpërblejë palën paditëse shoqerine “***” sh.p.k. nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare “Zgara Korçare” me dëmin jo-pasuror në shumën *** (***) lekë.
5. Rrëzimin e kerkese-padisë për vleren tjeter te demit te pretenduar prej saj.
6. Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës së paditur ne raport me pjesen e pranuar dhe te rrezuar te kerkese-padise.
7. Kundër këtij vendimi mund të behet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve afat që ky qe fillon nga e nesërmja e shpalljes se tij per palen prezent dhe nga e nesermja e dites se komunikimit te vendimit per palet ne mungese.
8. **U shpall sot me dt. 24. 11. 2016 ne Tirane.**

9. **SEKRETARE
GJYQAR**

GENCJANA DADA

ERVIN POLLOZHANI

Shpenzimet gjyqësore

Taksë padie	***lekë
Shpenzime eksperti	***lekë
Shpenzime perfqesimi Av. paditesit	***lekë
<u>Shpenzime njoftimi llog gjykates</u>	***lekë
Totali	**lekë

